



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për :	Bali Muarremaj , Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuçi , Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Suharekës	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI-së Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së	
Nga:	Jeton Qela , U.D. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 07.11.2023 Nr. 43-831
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Besim Myrtezani , U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
	Driton Xhafa , Zyrtar për monitorim të komunave	
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Suharekës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar **Rregulloren Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoha Komunale**, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Suharekës, dhe i nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Suharekës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në ministrit e linjës për shqyrtim të ligjshmërisë dhe Ministria e Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Ministria e Shëndetësi kanë kërkuar rishqyrtimin nga fusha dhe kompetenca e tyre.

Bashkangjitur gjeni vlerësimin e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe Ministrisë së Shëndetësi.

Rregullorja Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoba Komunale, miratuar nga Suharekë, datë 25.10.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, ka pranuar nga MAPL me datë 20.10.2023 Rregulloren Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoba Komunale, miratuar nga Suharekë, datë 25.10.2023.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, konstaton:

Fusha e ndërtimit

Komuna e Suharekës, duhet të veprojë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L - 110 për Ndërtim dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 për Taksat Administrative për Leje Ndërtimore, Leje Rrërimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës pasi që nga viti 2019 nuk ka bërë kërkesë për pëlqim paraprak të taksave në MMPHI për aprovim.

Fusha e Agjencionit kadastral

Rregullorja Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Suharekë, është në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Fusha e Mjedisit

Rregullorja Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Suharekë, nuk i ka paraparë tarifën për Leje Mjedisore Komunale sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017 (MMPH). për Dhënie të Lejes Mjedisore Komunale, gjegjësisht, neni 61 paragrafi 4 i rregullores duhet të jenë në përputhje me nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafet 1.1 dhe 1.2 të të njëjtit Udhëzim Administrativ.

Gjithashtu, Rregullorja nuk thirret në dispozitat e Ligjit për Mbeturina dhe si e tillë nuk është për komentim dhe shqyrtim.

Kjo rregullore po ashtu nuk interferon me dispozitat rregullative të Ligjit Nr.04/L-147 për Ujerat e Kosovës.

Fusha e Planifikimit Hapësinor

Në aspektin e planifikimit, Ligji për Planifikimin Hapësinor i lejon Autoritetit komunal të ofrojnë kopje të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor për secilin që i kërkon ato dhe i njëjti për çdo kopje mund të ngarkojë një taksë të kostos reflektuese.

Neni 22 , LIGJI NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

From: Fatmir Azemi

Sent: Thursday, November 2, 2023 9:50 AM

To: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>

Cc: Servet Spahiu <Servet.Spahiu@rks-gov.net>; Xhemail Metolli <Xhemail.Metolli@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>; Shendrita Latifi <shendrita.latifi@rks-gov.net>; Shiqeri Dermaku <Shiqeri.Dermaku@rks-gov.net>; Bashkim Shaqiri <Bashkim.Shaqiri@rks-gov.net>; Avni Ahmeti <Avni.Ahmeti@rks-gov.net>; Suzana Goranci <Suzana.Goranci@rks-gov.net>; Ramë Hamzaj <Rame.Hamzaj@rks-gov.net>; Miradije Gerguri <Miradije.Gerguri@rks-gov.net>; Florije Tahiri <Florije.Tahiri@rks-gov.net>; Nazmi Maxhera <Nazmi.Maxhera@rks-gov.net>; Rizah Muqolli <Rizah.Muqolli@rks-gov.net>; Lendita Sopa <Lendita.Sopa@rks-gov.net>; Nadir Shyqeriu <Nadir.Shyqeriu@rks-gov.net>

Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë

E nderuar,

Është shqyrtuar Rregullorja Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Suharekë, më datë 25.10.2023 dhe konstatohet si në vazhdim:

Sipas UA Nr. 02/2018 për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrëtimi dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës, duhet të dërgohet shkresa në Ministri (MMPHI), për aprovim, gjë që kjo komunë që nga viti 2019 nuk e ka bërë një kërkesë të tillë.

Me nderime,

Fatmir Azemi, DPHNB/DB

From: Nadir Shyqeriu

Sent: Monday, October 30, 2023 10:50 AM

To: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>; Ismail Hetemaj <Ismail.Hetemaj@rks-gov.net>; Shiqeri Dermaku <Shiqeri.Dermaku@rks-gov.net>; Bashkim Shaqiri <Bashkim.Shaqiri@rks-gov.net>; Servet Spahiu <Servet.Spahiu@rks-gov.net>

Cc: Avni Ahmeti <Avni.Ahmeti@rks-gov.net>; Xhemail Metolli <Xhemail.Metolli@rks-gov.net>; Fatmir Azemi <Fatmir.Azemi@rks-gov.net>; Suzana Goranci <Suzana.Goranci@rks-gov.net>; Ramë Hamzaj <Rame.Hamzaj@rks-gov.net>; Miradije Gerguri <Miradije.Gerguri@rks-gov.net>; Florije Tahiri <Florije.Tahiri@rks-gov.net>; Nazmi Maxhera <Nazmi.Maxhera@rks-gov.net>; Rizah Muqolli <Rizah.Muqolli@rks-gov.net>; Lendita Sopa <Lendita.Sopa@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>; Shendrita Latifi <shendrita.latifi@rks-gov.net>

Subject: RE: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë

E nderuar,

Agjencia Kadastrale e Kosovës shqyrtoi Rregulloren Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Suharekë, dhe e njëjta është në përputhje me aktet nënligjore të nxjerra nga MMPHI - Udhëzimet Administrative të MMPHI në fuqi.

Me respekt,

From: Rizah Muqolli

Sent: Tuesday, October 31, 2023 9:22 AM

To: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>

Cc: Shiqeri Dermaku <Shiqeri.Dermaku@rks-gov.net>; Visare Hoxha <Visare.Hoxha@rks-gov.net>

Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë

Përshëndetje

Rregullorja Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Suharekë, nuk i ka paraparë askund tarifat për Leje Mjedisore Komunale sipas UA 01/2017 (MMPHI).

From: Naim Alidema

Sent: Tuesday, November 7, 2023 8:54 AM

To: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>

Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë

From: Naim Alidema
Sent: Monday, November 6, 2023 9:40 AM
To: 'Sabrie.Rama@rks-gov.net' <Sabrie.Rama@rks-gov.net>
Cc: Ismail Hetemaj <Ismail.Hetemaj@rks-gov.net>; Shiqeri Dermaku <Shiqeri.Dermaku@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>; Visare Hoxha <Visare.Hoxha@rks-gov.net>; Malsore Jonuzi <Malsore.Jonuzi@rks-gov.net>; Abdullah Pirçe <Abdullah.Pirce@rks-gov.net>
Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë

E nderuar,

Referuar kërkesës lidhur me vlerësimin e Rregullores Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Suharekë, përgjigjen e gjeni si në vijim:
Nenit 61, paragrafi 4 i Rregullores Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoba komunale tarifa për tu pajisur me Leje Mjedisore Komunale për të gjitha veprimtaritë të përcaktuara në shtojcën e Udhëzimit Administrative për Leje mjedisore Komunale Nr.01/2017 duhet të jenë në përputhje me nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafet 1.1 dhe 1.2 të këtijë Udhëzimi Administrativ.

Me respekt,

From: Florije Tahiri
Sent: Tuesday, October 31, 2023 8:45 AM
To: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>
Cc: Shiqeri Dermaku <Shiqeri.Dermaku@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>; Lendita Sopa <Lendita.Sopa@rks-gov.net>
Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë

Përsëndetje e nderuar,

Pas shqyrtimit të kërkesës të MAPL me Numer protokoli: 43-831/1, të datës: 30.10.2023, për vlerësim të ligjshmërisë të Rregullores Nr.10-68660 për taksa komunale miratuar 25.10.2023 për taksa, tarifa dhe gjobat komunale për vitin 2024 miratuar nga KK Suharekë, Divizioni për mbeturina dhe kimikate vlerëson se Rregullorja në fjalë, nuk thirret në dispozitat e Ligjit për mbeturina dhe si e tillë nuk është për komentim dhe shqyrtim nga divizioni për mbeturina dhe kimikate.

Me respekt,

Florije Tahiri

From: Fatmire Mani

Sent: Monday, October 30, 2023 2:23 PM

To: Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>

Cc: Shiqeri Dermaku <Shiqeri.Dermaku@rks-gov.net>; Florije Kika <Florije.Kika@rks-gov.net>

Subject: RE: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë

Përsëndetje e nderuara Sabrije,

Rregulloren Nr.10-68660 për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Suhareke nuk interferon dispozitat rregullative të Ligjit Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës.

Me respekt,

Fatmire Mani

Zyrtare ligjore

Legal officer

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave

Department of Environmental and Water Protection

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktues

Ndërtesa e Re e Qeverisë (Ish Pallati i Mediave)

New Government Building (Former Media Palace)

Kati XV / Floor XV

T: (0)38 200 74086

E-mail: fatmire.mani@rks-gov.net

Web: <http://www.rks-gov.net/nmpli>

From: Suzana.Goranci

Sent: Wednesday, November 1, 2023 9:00 AM

To: Servet Spahiu <Servet.Spahiu@rks-gov.net>

Cc: Vjollca Puka <Vjollca.Puka@rks-gov.net>; Burbuqe Hydaverdi <Burbuqe.Hydaverdi@rks-gov.net>; Lindita Radoniqi

<Lindita.Radoniqi@rks-gov.net>; Labinota Jahja <Labinota.Jahja@rks-gov.net>; Arberore Velu <arbenore.velu@rks-gov.net>; Adelina

Vatovci <Adelina.Vatovci@rks-gov.net>; Sabrie Rama <Sabrie.Rama@rks-gov.net>

Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë

Përschendetje Drejtor,

Te poshteshenuar gjeni vleresimin profesional te shqyrtimit te ligjshmerise se vendimit

Gjitha te mirat,
Suzana

From: Lindita Radoniqi

Sent: Monday, October 30, 2023 1:50 PM

To: Suzana.Goranci <Suzana.Goranci@rks-gov.net>

Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë

Të nderuar,

Pas shqyrtimit të lëndës nga Kuvendi Komunal I Suharekës për Rregulloren Nr.10-68660 per taksa, tarifa dhe gjoba komunale, miratuar nga KK Suhareke.
me datë 28.09.2023. MAPL me nr. të protokollit 43-831/1 të dates 30.10.2023.

Divizioni i Planifikimit Hapësinor jep këtë mendim profesional: Divizion i Planifikimit Hapësinor duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-174 Per Planifikimin Hapësinor dhe aktet administrative në fuqi themi se:
Ligji Nr. 04/L-174 Per Planifikimin Hapësinor Neni 22, Kopjet e Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor: Autoritetet kompetente komunale ofrojnë kopje të Dokumenteve të Planifikimit Hapësinor për secilin që i kërkon ato. Autoriteti komunal mund të ngarkojë një taksë të kostos reflektuese për çdo kopje.

Driton Xhafa

From: Kadrije Sherifi
Sent: utorak, 07. novembar 2023. 14:58
To: Besim Murtezani; Xhevat Tafa; Driton Xhafa
Cc: Naim Bardiqi; Aferdita Syle Hoxha; Fisnike Kelmendi; Fjolla Shabani; Minire.Kazazi; Vjosa Kalaja
Subject: FW: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë
Attachments: 43-831-1-2023.pdf

Të nderuar,

Ministria e Shëndetësisë në mbështetje të nenit 81.4 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka bërë shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit në fjalë:

Rregulloren nr. 110-68660 Për taksa komunale të Komunës së Suharekes

Pas shqyrtimit të Rregullores në fjalë, sa i përket fushës së shëndetësisë është pjesërisht në harmoni me Udhëzimin Administrativ Nr.04/2007 Mbledhja dhe shfrytëzimi i mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të Institucioneve shëndetësore ndërsa **nuk është në harmoni** me Udhëzimin Administrativ Nr. 04/2013 për Certifikatat Shëndetësore në tërësi .

REKOMANDIM:

Neni 17 dhe 20 i Rregullorës nr. 110-68660 Për taksa komunale të Komunës së Suharekes të harmonizohet me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.04/2007

Neni 18 i Rregullorës nr. 110-68660 Për taksa komunale të Komunës së Suharekes të harmonizohen me shtojcën 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2013 për Certifikatat Shëndetësore

Me respekt,

From: Aferdita Syle Hoxha
Sent: Tuesday, October 31, 2023 9:18 AM
To: Kadrije Sherifi <Kadrije.Sherifi@rks-gov.net>
Cc: Fjolla Shabani <Fjolla.Shabani@rks-gov.net>
Subject: Fw: Shkresë përcjellëse nga MAPL me Rregulloren Nr.110-68660 KK Suharekë

Per adresim te kerkeses